



RAPORTI VJETOR 2023



www.kuzhina.net



Vizioni

Të bëhet sinonim i ushqimit të shëndetshëm, dhe të njihet si shembull i përsosshmërisë në ofrimin e produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetarët.

Misioni

Të vazhdojmë angazhimin për ushqim të shëndetshëm, me cilësi, standarde të larta, shije të mirë dhe çmim të volitshëm.

Përgjegjësia sociale

Investuam në kapitalin human. Avancimet profesionale në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, sigurisë së ushqimit, ndërmarrjes i kanë kushtuar rreth 9,739 euro.

Në këtë drejtim kemi nënshkruar kontratën tre-vjeçare për sigurimin shëndetësor të punëtorëve.

Ndërkohë për të mirën e përgjithshme investuam në instalimin e sistemit solar në hapësirën e ndërmarrjes, projekt ky i realizuar për herë të parë nga një ndërmarrje publike.



Trajnime për avancime profesionale gjatë vitit 2023

9,739.5 €



Sigurimi shëndetësor në 2023

5,736.5 €



Eko (solare, rregullimi oborrit, rrethoja e institucionit parashkollorë)

4,785.68 €

Përmbledhje financiare

Vitin 2023 e përmbyllëm me bilanc financiar **pozitiv**. Në të njëjtën kohë, ndërmarrja është kujdesur që obligimet e saja t'i kryej në afatet e parapara.



Të hyrat

1,096,381.29 €



Shpenzimet
dhe investimet

547,166.73 €



Pagat


554,729.09 €




Fitimi



2,747.91 €


Takimet e bordit dhe aksionarëve gjatë vitit 2023



Përgatitja e shujtave Janar – Dhjetor








Nr.	Kontrata	Data e nënshkrimit	Vlera në Euro
1	Regjistrimi i veturave për NPL Kuzhina Qendrore sh.a.	30.1.2023	594.72
2	Furnizim me paketime ushqimore	11.1.2023	9,666.00
3	Furnizimi dhe Instalimi i paisjeve për ujë, rrymë dhe ventilim	23.1.2023	33,100.00
4	Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve për Kuzhinën Qendrore sh.a.	3.4.2023	4,578.01
5	Renovimi i zyreve të takimit për Kuzhinën Qendrore sh.a.	27.4.2023	993.00
6	Riorganizimi i hapësirës së Depo-së për Kuzhinën Qendrore sh.a.	27.4.2023	980.00
7	Furnizimi dhe montimi i klimës dhe zhvendosja e klimës ekzistuese	19.5.2023	990.00
8	Furnizimi dhe montimi i rrjetave dekoruese	19.5.2023	2,140.20
9	Furnizim dhe montimi me Çiler modular për ftohje dhe ngrohje	21.6.2023	7,777.00
10	Ndërtimi i recepcionit dhe qëndrimit për punëtor	23.5.2023	15,423.55
11	Furnizimi dhe montim i xhamave dhe pllafonit të armstrongut	23.6.2023	983.00
12	Zhvendosja e dyerve dhe punimi i mureve nga knaufi	22.6.2023	990.00
13	Furnizim dhe montim i keramikave në depon e Kuzhines Qendrore	21.6.2023	975.10
14	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	26.12.2019	16,444.15
15	Furnizim me material higjienik	27.7.2023	6,553.00
16	Furnizim me artikuj ushqimor	11.8.2023	37,862.00
17	Furnizim me pemë dhe perime	19.9.2023	81,855.80
18	Shërbime të udhëtimit me aeroplan	18.9.2023	690.00
19	Sigurimi shëndetësor dhe aksidental për punëtorët e Kuzhinës Qendrore	1.8.2023	61,603.20
20	Furnizim me artikuj ushqimor mbështetës	10.10.2023	9,308.34
21	Hostimi dhe Mirëmbajtja e ueb-faqes së Kuzhinës Qendrore 12 muaj	30.10.2023	944.40
22	Furnizimi dhe monitimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore- Ri-tender	18.9.2023	26,984.22
23	Furnizim me paketime ushqimore	14.11.2023	9,730.62
24	Sigurimi i veturave të Kuzhinës Qendrore	14.12.2023	705.29
25	Furnizim me dhurata për fundvit	14.12.2023	970.00
TOTAL			332,841.60

TM1



ZYRA E PROKURIMIT

Duke pasur parasysh procesin e konsolidimit të ndërmarrjes Zyra e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar disa projekte të cilat kanë qenë të domosdoshme, të nevojshme dhe të duhura për mirë- funksionimin e ndërmarrjes.

Aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e Kuzhinës, në vijim janë të listuar aktivitetet e zhvilluara dhe ato të cilat janë në proces.

Nr	Aktiviteti i Prokurimit	Shuma (€)	Procesi
1	Furnizimi dhe monitimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore	36,000.00	Në ankim
2	Furnizim me paketime ushqimore	9,666.00	Kontraktuar
3	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë për nevojat e Kuzhinës Qendrore	98,000	Anuluar
4	Furnizimi dhe Instalimi i pajisjeve për ujë, rrymë dhe ventilim	33,100.00	Kontraktuar
5	Regjistrimi i veturave për NPL Kuzhina Qendrore sh.a.	594.72	Kontraktuar

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS:

Departamenti i Administratës në bazë të dispozitave të brendshme normative i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv. Aktualisht në ndërmarrjen tonë në këtë departament në funksion të plotë janë katër sektor: Sektori i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Projekteve dhe sektori i Logjistikës, ai i Trajnimeve dhe i IT-së Funksionet tjera të sektorëve të tjerë do të funksionalizohen në bazë të planifikimeve të brendshme të institucionit tonë, kurse vlen të theksohet se obligimet dhe detyrat që kanë qenë në kompetencë të sektorëve të cilat, ende nuk janë të plotësuar me resurse njerëzore i kanë mbuluar stafi aktual i administratës në koordinim të rregullt me Kryeshefin Ekzekutiv dhe me departamentet e tjera.

Aktivitetet në Departamentin e Administratës

Departamenti i Administratës në periudhën e 3 mujorit të parë për vitin 2023 ka kryer këto aktivitete:

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës “Në Shtëpi” që ndërmarrja jonë N.P.L “Kuzhina Qendrore” sh.a ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Administratës në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjellë procesin e dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollë, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës.

Në respektim të bazësligjore dhe në ndjekje të rregullt të procedurave, ky departament në suaza të kompetencave, ka proceduar me plotësimin e kushteve për bartjen e veturave dhe ndryshimin e targave nga 01Z ne 01, si dhe regjistrimin e tyre në emër të ndërmarrjessonë.

Gjatë kësaj kohe ndërmarrja jonë përmes PTK-së ka arritur të sigurojë shërbimin telefonik falas për klient, 0800, shërbim ky i cili mundëson që të gjithë të interesuarit për shërbimet tona, mund të telefonojnë pa pagesë në numrin e caktuar.

Në bazë të obligimeve sektoriale departamenti jonë gjatë kësaj periudhe ka bërë konstatimet mujore për operatorët ekonomik, kjo sipas vendimit të KE-së për të mbikëqyrë kontratat e operatorëve privat.

Sipas projektit të zhvilluar dhe të dorëzuar në vitin 2022 pranë Ministrisë së Financave dhe Transfereve, kemi bërë përditësimin e planit për realizimin e projektit në përputhje me shumën të cilëne kemi fituar. Stafii departamentit tonë si mbikëqyrës të këtij projektika bërë edhe planin e furnizimit për artikujt sipas kushteve dhe kërkesës së kontratës.

Gjatë kësaj kohe, bashkë me zyra e IT-së kemi bërë të mundur kyçjen e të gjitha paisjeve kompjuterike (PC) me Lan. Në këtë dimension ne kemi kontaktuar operatorët kontraktual Telkos dhe PTK, të internetit dhe kemi kërkuar nga ta që të shtohet kapaciteti i shpejtësisë, gjë e cila ka ndodhur pjesërisht.

Gjatë kësaj periudhe, zyra e IT-së ka ndihmuar zyrën e mediave për mirëmbajtjen e rrjeteve sociale Instagram dhe Facebook, duke krijuar dizajnë të ndryshme kryesisht të ushqimeve, të cilat më pas janë publikuar.

Është punuar në ndryshimin e logos së ndërmarrjes si dhe është bërë punë e rëndësishme në dizajnimin e menysë së re.

Sigurisht se në këta tre (3) muaj të parëtë vitit 2023, pjesë e rëndësishme ka vazhduar të jetë logjistika. Përmes saj ne kemi mundësuar dërgimin në kohë të shujtave për fëmijët e Institucioneve Parashkollore, po ashtu ka vazhduar në mënyrë të rregullt dhe në kohë edhe dërgimi i porosive tek sektori privat dhe tek qendrat sociale.

Ky sektor ndërkohë është angazhuar edhe në mirëmbajtjen të hapësirave të jashtme të ndërmarrjes si dhe ndihmesën e nevojshme për departamentet e tjera të institucionit tonë.

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesëne përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, në të gjitha sektorët janë bërë mënytë të cilat janë pasuruar me specialitete të ndryshme, po ashtu, të gjithë stafi janë paisur me librezasaniare.

Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektorë: *Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale (Aktash, Tophane) si dhe sektori privat.*

Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Institucioneve Parashkollore është mbledhur komisioni, është bërë implementimi dhe vlerësimi i menysë së re e cila është katër javore dhe është epasur me vlera të larta ushqyese, po ashtu ka produktetë reja në meny me të cilat fëmijët me kalimine kohës janë duke u adaptuar me shije të re.

Nësektorin e Institucioneve Parashkollore kemi përgatitur “Doracak për shërbimin dhe sigurinë e ushqimit” ku janë të përfshira:

- Higjiena personale dhe kujdesi,
- Rregullat e veshjes në punë
- Rregullat higjienike dhe të mirësjelljes gjatë servimit të ushqimit
- Fasiliteti sanitar
- Ushqyerja e fëmijëve
- Menaxhimi i papastërtive (mbetjeve)

Doracaku është punuar bazuar në **LIGJIN 037-L016** për ushqimin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Poashtu në departamentin e prodhimit janë vendosur rregullat për mirëmbajtjen dhe sigurinë e ushqimit nëpërmjet kontrollimit të temperaturave të magazinave dhe frigoriferëve,

Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve merren mostrat nga çdo lloj i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë:

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar. Gjatë periudhësraportues, Departamenti ka arritur të përgatisë 78,974 shujta për kopshte publike si dhe kopshteme bazë komunitet 52,785 shujta.

Sektori qendrat sociale

Në departamentin e prodhimit është po ashtu sektori qendrës sociale ku në këtë sektor përgatitet ushqimi për dy qendra: Qendra në Aktash si dhe Qendra në Tophane, gjatë periudhës tre mujore është bërë implementimi i menysë, e cila është dy javore është e pasur me vlera të larta ushqyese, çdo ditë shkojnë gjellatë ndryshme të shoqëruar gjithmonë me sallatë ose djathë.

Sektori privat

Sektori privatë gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyernë cilësinë si dhe është pasuruar menya me produkte të reja lloje të ndryshme të gjellrave, lloje të ndryshme të brumërave.

Sektori privat ka zhvilluar po ashtu “fingerfood” ku kemi pasur organizime të ndryshme kokteje rasti .

Sektori privat gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur të nënshkruaj tri kontrata të reja për përgatitjen e ushqimeve lloje të ndryshme.

Përgatitja e shujtave Janar – Mars

Numri i fëmijëve	JANAR	SHKURT	MARS
Institucionet Parashkollore Publike	20601	20170	31665
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	14382	13115	20170
Qendrat Sociale	5100	4500	6900
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	n/a	n/a	2550
Porosi Private	3-biznese, 2170 porosi	6-biznese, 2695 porosis	6-biznese, 2760 porosi

DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT

Në tremujorin e parë departamenti i furnizimit dhe distribuimit është funksionalizuar thuajse tërësisht, duke angazhuar staf shtesë për të kryer detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë. Megjithatë gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësitë për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës” Në shtëpi”, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës.

Shpërndarja e shujtave për tre mujorin e parë është paraqitur në tabelën me poshtë. Numri i fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike ka shënuar rritje për tre mujorin e parëtë vitit 2023.

Rritje tejet pozitivendërmarrja ka shënuar edhe në sektorin privat, ku nga tri (3) biznese që i kemi pasur të kontraktuara në fillim të vitit, kemi arritur deri në gjashtë (6) biznese.Me mbylljen e tre mujorshit të parë, ndërmarrja ka shpërndarë në total **7625** porosi private.

Po ashtu, departamenti ynë ka bërë edhe shpërndarjen e shujtave shtesë, pjesë e projektit të fituar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shpërndarja ka filluar në fillim të muajit mars, ku në dy qendrat sociale (Aktash dhe Tophane) janë shpërndarë nga 75 shujta, në total 150 shujta ditore.

Numri i fëmijëve	JANAR	SHKURT	MARS
Institucionet Parashkollore Publike	20601	20170	31665
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	14382	13115	20170
Qendrat Sociale	5100	4500	6900
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	n/a	n/a	2550
Porosi Private	3-biznese, 2170 porosi	6-biznese, 2695 porosis	6-biznese, 2760 porosi

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave kujdeset për sigurimin e likuiditetit të ndërmarrjes, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe investimet e planifikuara.

Ndërmarrja ka siguruar të hyra nga aktiviteti primar i saj dhe shpenzime të cilat i përcjellin këto të hyra. Shpenzimet kryesisht janë kosto direkte në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit, gjithashtu këtë periudhë ka pasur shpenzime të periudhës jo prodhuese indirekte.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit afarist ndërmarrja ka krijuar shpenzime të përgjithshme variable të tilla si, shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet për derivate.

Bazuar në planin paraprak të prokurimit, ndërmarrja këtë periudhë të vitit ka iniciuar procedura për furnizim me disa produktet të lëndës së parë dhe gjithashtu ka bërë investim dhe riorganizim të kuzhinës.

Shpenzimet dhe llojet e tyre

	Janar	Shkurt	Mars	Totali
Totali i shpenzimeve	25,321.91	31,668.88	56,294.72	113,285.51
Lënda e parë	24,279.93	26,623.60	33,194.44	84,097.96
Shpenzime për naftë	467.85	452.51	657.81	1,578.17
Shpenzime për konkurs - bord			80.5	80.50
Shpenzime për telefon	88.98	210.29	16.66	315.93
Shpenzime për trajnime-avancim			150	150.00
Shpenzime të reprezentacionit	124.7	58.8	165.02	348.52
Shpenzime të internetit		50.85	50.85	101.70
Shpenzime të energjisë elektrike		1947.48	1,373.16	3,320.64
Shpenzimet për zyre	360.45	2,325.35		2,685.80
Shpenzim Aset-Kuzhina			12,682.52	12,682.52
Shpenzime tjera			7,923.76	7,923.76

Zëri i cili merr pjesë me së shumti në shpenzimet e ndërmarrjes është Furnizimi me lëndë të parë.

Nga dhjetori i vitit të kaluar, ndërmarrja ka filluar mbulimin e këtyre shpenzimeve me të hyra vetanake, kurse në shkurt të këtij viti ka përfunduar edhe kontrata e fundit “Furnizim me brumëra” për të cilën vlerë është zbritur nga fatura kryesore për Komunën e Prishtinës. Andaj mund të shohim një rritjet të konsiderueshme të këtyre shpenzimeve që nga ai muaj. Tashmë, ndërmarrja bën ndarje buxhetore të nevojshëm për sigurimin e likuiditetit për pagesën e këtyre shpenzimeve të nevojshme për prodhim.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka iniciuar procedurën për renovimin e Kuzhinës, instalimin e ujit rrymës dhe ventilimit, që deri në përfundim të muajit të tretë ka arritur vlera neto e saj 12,682.52 euro(situacioni i parë)

Ndarja buxhetore për paga për tre mujorine parë të vitit 2023

Viti 2023	Paga Bruto
Muaji Janar	35,992.50
Muaji Shkurt	42,863.30
Muaji Mars	45,183.39
Totali për tre muaj	124,039.19

Në tre mujorin e parë të vitit 2023, Ndërmarrja ka ndarë buxhet në vlerë prej 124,039.19 euro të destinuar për paga.

Ky buxhet është ndarë si në vijim për departamente të caktuara.

Departamenti me pjesëmarrjen më të lartë në paga është ai i Prodhimit, kjo si rezultat i numrit më të lartë të punëtorëve, si rrjedhojë e fluksit dhe kërkesës së madhe për prodhim. Pas kësaj numrin më të lartë të punëtorëve dhe pjesëmarrjen më të lartë në totalin e pagave është sektori i administratës.

Pjesëmarrja në totalin e pagave me përqindje

Viti 2023	% e pjesëmarrjes në totalin e pagav
Aksionar	3.04%
Bordi i drejtorëve dhe KE	11.84%
Drejtorët e departamenteve dhe zyrtarët e lartë	11.64%
Departamenti i Administratës	18.54%
Departamenti i Prodhimit	51.87%
Departamenti i Furnizim dhe distribuim	3.16%
Totali për tre muaj	100%

Të hyrat dhe llojet e tyre


Shitje	IP dhe QS	Operatore Privat	Totali
Muaji Janar	70,696.52	3,447.54	74,144.06
Muaji Shkurt	78,509.70	4,737.16	83,246.86
Muaji Mars	99,551.13	5,129.15	104,680.28
Totali për tre muaj 248,757.35		13,313.85	262,071.20

Nga tabela lartë mund të shohim të hyrat që ka realizuar ndërmarrja gjatë këtij tre mujori të parë. Kolona e parë tregon shumën totale mujore në Institucione Parashkollore dhe Qendra Sociale.

Numri i fëmijëve ka shënuar rritje nga muaji në muaj.

Gjithashtukëtë periudhë kohore ka pasur rritjetë të hyrave nga shitja tek operatorët privat. Trendi pozitiv i këtyre shitjeve ka arritur vlerën 13,313.85 euro. Totali i të hyrave pa TVSH, për ndërmarrjen është 262,071.20 euro.

Raporti i të hyravedhe shpenzimeve mujore 2023



Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH	Janar	Shkurt	Mars	Total
	9,590.91	10,376.80	10,668.83	30,636.54

Ndërmarrja i ka kryer me sukses të gjitha obligimet për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Totali i këtij tre mujori arrin vlerën 30,636.54 euro.


Fitimi për muaj

Fitimi	Janar	Shkurt	Mars	Total
	12,829.65	8,714.68	3,202.17	24,746.5

Ndërmarrja ka shënuar një bilanc pozitiv të fitimit, me një trend rënës. Ky regres pozitiv ka ardhur si rezultat i rritjes së investimeve kapitale të cilat janë shpjeguar më lartë.

Raporti i fitimit mujor

RAPORTI I FITIMIT MUJOR 2023



Përmbledhje:

Ndërmarrja ka shënuar rritje në përfshirjen e tregut privat shitur me një mesatare prej 4,500 euro në muaj.

Pikën më të lartë të fitimit ndërmarrja e ka shënuar në muajin Janar, me vlerë 12,829.65 euro.

Buxheti i pagave është rritur nga muaji Janar në Shkurt, kurse në muajin Mars kemi pasur një trend me stabil të buxhetit.

Shpenzimet janë rritur në tre muaj, si rezultat i rritjes së kërkesës për lëndë të parë dhe realizimit të investimeve.

Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes

Periodha raportuese është karakterizuar më një vëllim të punëve në drejtim të rritjes së kapaciteteve sa i përket resorit të burimeve njerëzore. Është përgatitur procesi rekrutues për nevojat për staf shtesë për ndërmarrjen. Gjatë kësaj periudhe kohore ndërmarrja ka organizuar trajnimin e stafit të ndërmarrjes. Tematika e këtij trajnimi ka qenë menaxhimi i kontratave në prokurimin publik, sigurinë në punë etj.

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Si rezultat i kësaj analize është përgatitur dokumenti për nevojat e ndërmarrjes për staf shtesë.



ZYRA E PROKURIMIT

Këto tetë (8) aktivitete të prokurimit janë kontraktuar gjatë këtij tre (3) muhori. Aktivitetet janë zhvilluar për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të rritur efikasitetin e punës së Kuzhinës Qendrore. Aktivitet më i jashtëzakonshëm është Furnizim dhe montimi me Çiler modular për ftohje dhe ngrohje, pasi ka ardhur si rezultat i prishjes së Çilerit ekzistues dhe temperaturave të larta jemi obliguar të rregullojmë sa më parë këtë sistem. Aktivitetet e tjera janë kryesisht vlera që zhvillohen minimale nën 1,000 euro. Ndërtimi i recepsionit është kontraktuar dhe janë duke u zhvilluar punimet. Furnizimi dhe montimi i rrjetave dekoruese kanë përfunduar edhe punimet. Projekti i furnizimit dhe i montimit të rrjetave dekoruese, është projekt që është realizuar për nevojën të Institucionit Parashkollorë Gëzimi Ynë. Një veprim i tillë ka ardhur pas kërkesës nga ky institucion parashkollorë dhe pas kafshimit nga qentë endacakë brenda oborrit të këtij institucioni të fëmijës që ka qenë në atë moment në oborr. E tërë projekti është donacion i Kuzhinës për IP.

Nr.	Aktiviteti i Prokurimit	Shuma (€)	Procesi
1	Mirëmbajtja dhe servisi i paisjeve për Kuzhinën Qendrore sh.a.	4,578.01	Kontraktuar
2	Renovimi i zyrave të takimit për Kuzhinën Qendrore sh.a.	980.00	Kontraktuar
3	Furnizimi dhe montimi i rrjetave dekoruese	2,140.20	Kontraktuar
4	Ndërtimi i recepsionit dhe qëndrimit për punëtor	15,423.55	Kontraktuar
5	Furnizim dhe montimi me Çiler modular për ftohje dhe ngrohje	7777.00	Kontraktuar
6	Furnizimi dhe montimi i xhamave dhe plafonit të armstrongut	900.00	Kontraktuar
7	Zhvendosja e dyerve dhe punimi i mureve nga knaufi	990.00	Kontraktuar
8	Furnizim dhe montimi i qeramikave në deponë të Kuzhinës Qendrore.	975.10	Kontraktuar
Totali i mjeteve të planifikuara për shpenzim		33,763.89	

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës “Në Shtëpi” që ndërmarrja jonë N.P.L “Kuzhina Qendrore” sh.a. ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Administratës në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjellë procesine dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollore dhe tek qendrat sociale, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës.

Ndërmarrja në këtë afat kohor ka nënshkruar marrëveshje me Ndërmarrjen Publike Banesore, e cila do t'i ndihmoi shumë ndërmarrjes sonë për përfundimin e disa projekteve infrastrukturore, si dhe mirëmbajtjen e disa paisjeve të cilat janë vitale në punën e përditshme të ndërmarrjes tonë.

Përgatitja dhe prezantimi para IP të rregullave të shpërndarjes dhe kujdesit ndaj cilësisë së ushqimit në Çerdhe dhe në objekt.

Në këtë periudhë kohore kemi trajnuar disa punonjës të stafit mbi pozicionin e Sigurisë në Punë, të njëjtit janë certifikuar mbi trajnimin që kanë kryer.

Sa i takon Burimeve Njerëzore, kemi bërë ri-sistemimin e dosjeve të punëtorëve, për të njëjtit kemi kërkuar dokumentet shtesë të cilat ju kanëmunguar.

Në baza të rregullt janë regjistruar të gjitha vendimet, njoftimet, kërkesat apo ankesat të cilat kanë ardhur në drejtim të departamentit tonë.

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, në të gjitha sektorët janë bërë menytë të cilat janë pasuruar me specialitete të ndryshme.

Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektorë: **Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale(Aktash, Tophane) si dhe sektoriprivat.**

Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Institucioneve Parashkollore është bërë implementimi dhe vlerësimi i menysë së re, e cila është katër javore dhe është e pasur me vlera të larta ushqyese, po ashtu ka produkte të reja në meny me të cilat fëmijët me kalimin e kohës janë duke u adaptuar me shije të re.

Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve merren mostrat nga çdo lloje i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë:

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike
- Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike si dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar.

Ndërmarrja ka arritur marrëveshje me IKSHPK për kontrollin rutine të ambientit dhe ushqimit. Mostrat të cilat merren analizohen dhe komentohen rezultatet me rekomandimet e dhëna nga instituti të cilat me pas zbatohen nga Kuzhina Qendrore.

Në periudhën në fjalë për këtë pjesë të departamentit të prodhimit janë përgatitur dhe shërbyer 129 mijë e 515 shujta të ngrohta për fëmijët e vendosur në institucionet parashkollore publike dhe ato më bazë në komunitet.

Qendrat sociale

Në departamenti e prodhimit është po ashtu sektori i qendrës sociale ku në këtë sektor përgatitet ushqimi për dy qendra: Qendra në Aktash si dhe Qendra në Tophane. Gjatë periudhës tre mujore është bërë implementimi i menysë, e cila është dy javore është e pasur me vlera të larta ushqyese, çdo ditë shkojnë gjëlla të ndryshme.

Ndërkohë sa i përket pjesës së kontratës në shtëpi, ku behet fjalë për përgatitjen e ushqimit për familjet me gjendje të rënd ekonomike, janë përgatitur dhe shërbyer 17 mijë e 400 shujta


Sa i përket projektit të ri të fituar nga Qeveria e Kosovës, Kuzhina në periudhën raportuese ka përgatitur dhe shërbyer ushqimet e paketuara 8400 shujta të ngrohta.

Sektori privat

Sektori privat gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyer në cilësinë si dhe është pasuruar menya me produkte të reja lloje të ndryshme të gjellrave, lloje të ndryshme të brumërave. Është arritur objektivi këtij tremujorikë ka qenë 8000 euro në muaj shitje në këtë sektor. Sektori privat ka zhvilluar po ashtu “finger food” ku kemi pasur organizime të ndryshme kokteje rasti. Gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur të zgjerojë bashkëpunimin për evente me të mëdha edhe me individ privat. Shpërndarja e shujtave për tre mujorine dytë është paraqitur në tabelën me poshtë. Numri i fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike ka shënuar rritje për tre mujorin e parë të vitit 2023.

Përgatitja e shujtave Prill–Maj–Qershor

Numri i fëmijëve	Prill	Maj	Qershor
Institucionet Parashkollore Publike	21,203	30,397	27,376
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	13,920	18,434	18,185
Qendrat Sociale	4,800	6,300	6,300
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	2,250	3,000	3,150
Porosi Private	9-biznese	7-biznese	12-biznese
	1440 porosi	2636 porosi	3126 porosi



DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik.Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës,sipas Kontratës “Në shtëpi”, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës.

Shpërndarja e shujtave për tre mujorine parë është paraqitur në tabelën me poshtë. Numri i fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike ka shënuar rritje për tre mujorin e parë të vitit2023.

Rritje tejet pozitive ndërmarrja ka shënuar edhe në sektorin privat, ku nga tri (3) biznese që i kemi pasur të kontraktuara në fillim të vitit,kemi arritur deri në gjashtë (6) biznese ne periudhën e parë të vitit.Kurse në këtë periudhë duke përfshirëedhe bizneset të cilat kanë marrë shërbimine cateringut, kemi arritur deri në 12 biznese të shërbyer në Përgatitja e rregullt mujore e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomikpër 6 njësitë dhe plotësimi i rregullt mujor i specifikacionit të furnizimit të kalkuluar për çdo artikull ushqimor.

Vlera totale e furnizimit për TM2 2023 është :

Nr	Operatorët e Furnizimit	Prill 2023	Maj 2023	Qershor 2023	Mbetja financiare nga vlera totale e kontraktuar
1	ENZO SHPK- Kontratë Korniz	8,820.05€	11,618.93	12,001.97	16,881.42
2	NTP RIKI Loti 1 - AQP	3,590.00€	6,645.50	5,824.20	38,674.60
3	Apetit Loti 2 - AQP	1,228.16€	1,843.00	2,311.60	13,355.44
4	Hajdini Comerc -Loti 3 - AQP	3,792.00€	5,540.00	3,473.20	64,240.40
5	Beni Dona Plast - Loti 4 - AQP	1,423.70€	2,872.04	3,000.64	16,609.82
6	Dauti Comerc- Loti 5 - AQP	2,735.14€	5,778.68	5,121.03	59,732.82
7	Premium Bakery - AQP	7,203.29€	10,784.61	10,160.29	40,189.56
	Total furnizime	28,792.34€	45,082.76	41,892.93	

Në këtë tabelë janë të përcaktuar 7 operatorë të cilët bëjnë furnizime për 3 kategoritë ushqimore si :

- Produkte me origjinë bimore,
- Produkte me origjinështazore ,
- Produkte tjera mbështetëse.

Për angazhimin tremujor të praktikantëve, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë – KIESA, si dikaster i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, do t'i përkrah praktikantët me pagë 250.00 Euro (Bruto) për muaj nga Buxheti i Kosovës, ndërsa ndërmarrja nuk ka obligim financiar ndaj këtyre praktikantëve.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave kujdeset për sigurimin e likuiditetit të ndërmarrjes, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe investimet e planifikuara.

Ndërmarrja ka siguruar të hyra nga aktiviteti primar i saj dhe shpenzime të cilat i përcjellin këto të hyra. Shpenzimet kryesisht janë kosto direkte në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit, gjithashtu këtë periudhë, ka pasur shpenzime të periudhës jo prodhuese indirekte.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit afarist ndërmarrja ka krijuar shpenzime të përgjithshme variable të tilla si shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet për derivate.

Bazuar në planin paraprak të prokurimit, ndërmarrja këtë periudhë të vitit ka iniciuar procedura për furnizime të disa produktet të lëndës së parë dhe gjithashtu ka bërë investim dhe riorganizim të kuzhinës.

	Prill	Maj	Qershor	Totali
Totali i shpenzimeve	35,302.61	64,177.41	48,473.10	147,953.12
Lënda e parë	32,424.25	40,487.12	37,361.62	110,272.99
Shpenzime për naftë	458.45	448.34	570.77	1,477.57
Shpenzime për konkurs	0	0	0	0
Shpenzime për telefon	26.13	88.98	158.11	273.22
Shpenzime për trajnime-avancim	0	179.5 2,080 (jashtë vendit)	0	2,259.5
Shpenzime të reprezentacionit	138.14	211.02	94.23	443.39
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55
Shpenzime të ujit		5.2	7.6	12.8
Shpenzime të energjisë elektrike	1,232.02	1,466.85	2,974.93	5,673.80
Shpenzime për material shpenzues (zyre)	125.81	0	124.74	250.55
Shpenzime për materiale higjienike	140.08	830.7	0	970.78
Shpenzime për dezinfektim	42.37	0	0	42.37
Shpenzime të reklamës		64.41	159.32	223.73
Shpenzimet për paketime ushqimore	251.27	575	430.93	1,257.2
Shpenzimet për zyrë	413.24	605.37	503.24	1,519.35
Shpenzim Aset-Kuzhina		17,040.37	838.98	17,879.35
Shpenzime të tjera				

Zëri i cili merr pjesë me së shumti në shpenzimet e ndërmarrjes është Furnizimi me lëndë të parë. Për këtë periudhë kohe ndërmarrja ka shpenzuar 110,272.99 euro për blerjen e lëndës së parë.

Krahasuar me periudhën e parë të vitit, ndërmarrja ka rritur për 26,175.03-euro furnizimet me lëndë të parë.

Zëri tjetër që zë vend në ndarjen buxhetore të shpenzimeve është ai për energji elektrike i cili për këtë periudhë ka arritur vlerën prej 5,673.80euro.

Investimet në ngritjen profesionale të stafit në këtë periudhë kanë arritur vlerën prej 2,259.5 euro.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka përfunduar procedurën për renovimin e Kuzhinës, instalimin e ujit rrymës dhe ventilimit, vlera e situacionit të dytë është 17,040.37euro. Investim ne vlerë minimale është vendosja e klimës montuese në depo për ruajtjen e mallit, me vlerë 838.98euro.

Ndarja buxhetore për paga për tre mujorin e dytë të vitit 2023 (euro)

Viti 2023 – TM2	Paga Bruto
Totali	131,105.70 €

Në tre mujorin e parë të vitit 2023, Ndërmarrja ka ndarë buxhet në vlerë prej 131,105.70 euro të destinuar për paga. Departamenti me pjesëmarrjen më të lartë në paga është ai i Prodhimit, kjo si rezultat i numrit me të lartë të punëtorëve, si rrjedhojë e fluksit dhe kërkesës së madhe për prodhim. Pas kësaj numrin më të lartë të punëtorëve dhe pjesëmarrjen më të lartë në totalin e pagave është sektori i administratës.

Pjesëmarrja në totalin e pagave me përqindje

Viti 2023	% e pjesëmarrjes ne totalin e pagave
Aksionar	3.04%
Bordi i drejtorëve dhe KE	11.84%
Drejtorët e departamenteve dhe zyrtarët e lartë	11.64%
Departamenti i Administratës	18.54%
Departamenti i Prodhimit	51.87%
Departamenti i Furnizim dhe distribuim	3.16%

Totali për tre muaj	100 %
----------------------------	--------------

Të hyrat dhe llojet etyre (euro)


Shitje	IP dhe QS	Operatore Privat	Totali
Muaji Prill	67,666.10	3,817.22	71,483.32
Muaji Maj	93,442.63	6,026.52	99,469.15
Muaji Qershor	87,900.25	6,533.39	94,433.64
Totali për tre muaj 249,009.00		16,377.13	265,386.1

Nga tabela lartë mund të shohim të hyrat që ka realizuar ndërmarrja gjatë këtij tre mujori të dytë. Kolona e parë tregon shumën totale mujore në Institucione Parashkollore dhe Qendra Sociale.

Krahasuar me periudhën e parë të vitit në këtë sektor (IP dhe QS) ndërmarrja ka shënuar rritjeve të 251.65 euro.

Këtë periudhë kohore ka pasur rritje të të hyrave nga shitja tek operatorët privat. Trendi pozitiv i këtyreshitjeve ka arritur vlerën 16,377.13euro, kurse në periudhën e parë ka qenë 13,313.85 euro. Totali i të hyrave pa TVSH, për ndërmarrjen është 265,386.1 euro. Rritje në totalin e të hyrave ka shënuar ofrimi i shërbimit në sektorin privat. Rritja prej 3,314.9 euro në këtë periudhë ka ardhur si rezultat i rritjes së shërbimit të cateringut, shpërndarjes tek klientë të biznesit dhe atyre privat.

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve mujore




Pagesa e Tatimit mbi Vlerëne Shtuar (TVSH)

TVSh	Prill	Maj	Qershor	Total
	8,135.49	8,392.01	10,742.69	27,270.19 €


Ndërmarrja i ka kryer me sukses të gjitha obligimet për Tatimin mbi Vlerëne Shtuar. Totali i këtijtre mujori arrin vlerën 27,270.19euro.

Ndërmarrja ka shënuar një bilanc negativ të fitimit. Ky regres ka ardhur si rezultat i rritjes së investimeve kapitaletë cilat janë shpjeguar më lartë.

Raporti i fitimit mujor 2023



Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve krahasim TM1- TM2



Tre mujorshin e dytë të vitit ndërmarrja e ka mbyllur me bilanc negativ si rrjedhojë i investimeve të rritura sipas Planit të Biznesit..

Buxheti i pagave ka pasur një trend të qëndrueshëm të shpërndarjes së buxhetit.

Shpenzimet janë rritur në tre muaj, si rezultat i rritjes së kërkesës për lëndë të parë dhe realizimit të investimeve.

Kontrollet laboratorike

Duke qenë se fushë veprimtaria e ndërmarrjes është gastronomia, përgatitja, paketimi dhe shërbimi i llojeve të ndryshme të ushqimit dhe të shtyrë nga nevoja për t'u siguruar së shërbimet tona janë të sigurt dhe cilësore, kemi arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë për kryerjen e kontrolleve të pa paralajmëruara brenda ambienteve të punës dhe Kuzhinë dhe në ambientet e tjera ku shërbehet ushqimi.

Nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje e deri më tash IKSHP ka realizuar 7 kontrolle/analiza bakteriologjike dhe analizave kimike si dhe është kërkuar një mendim profesional për mostrën lakër.

Kur jemi tek analiza e fundit, IKSHP ka dhënë rekomandim që sasia e lakrës që është testuar të hiqet nga konsumi dhe si e tillë të largohet nga ambientet e Kuzhinës. Janë ndërmarrë të gjitha veprimet sipas rekomandimeve të IKSHP-së.

Ndërkohë sa i përket analizave bakteriologjike dhe analizave kimike, të gjeturat nga IKSHP janë se nuk janë gjetur elemente bakteriologjike brenda mostrave të marra për testim.

Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes

Periudha raportuese është karakterizuar më një vëllim të punëve në drejtim të rritjes së kapaciteteve sa i përket resorit të burimeve njerëzore. Gjatë kësaj periudhe kohore ndërmarrja ka organizuar trajnimin e stafit të ndërmarrjes.

TRAJNIMI SALES BUTCOM dhe MINDSETS 4 sukses- Duke marr parasysh zhvillimet që ka ndërmarrja për t'i arritur objektivat e saj në trajnimin e stafit në këtë periudhë janë zhvilluar 2 trajnime profesional, ku është përfshirë një gamë e gjerë e strategjive dhe praktikave më efektive të zhvillimit të aftësive të shitjes duke pasur një avantazh konkurrues në tregun e punës.

Në kuadër të thirrjes publike të Ministrisë së Tregtisë dhe industrisë për “NDËRMARRJET NË KOSOVË PROGRAMI “INTERNSHIP BIZNESI - 2023”, edhe këtë vit kemi aplikuar në këtë projekt brenda afatit të paraparë me kërkesë në sektorin e burimeve njerëzore, departamentin e operativës për angazhim të 3 praktikanteve në fushën (profilin) e Gastronomisë për 3 muaj gjatë vitit 2023.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, formësimi i kuadrove të reja dhe bartja e njohurive teorike në praktikë të fituara gjatë studimeve, si dhe mundësia e punësimit të të rinjve.

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Si rezultat i kësaj analize është përgatitur dokumenti për nevojat e ndërmarrjes për staf shtesë.



ZYRA E PROKURIMIT

Aktivitetet e prokurimit këtë periudhë kanë vazhduar sipas planifikimit të prokurimit dhe sipas nevojave të domosdoshme për mirë-funksionim të ndërmarrjes për më tepër tabela në vijim:

Tabela 1. Aktivitetet e prokurimit

Nr.	Aktiviteti i Prokurimit	Shuma (€)	Procesi
1	Furnizim me material higjienik	6,553.00	Kontraktuar
2	Sigurimi shëndëtsor dhe aksidental për punëtorët e Kuzhinës Qëndrore	61,603.20	Kontraktuar
3	Furnizim me artikuj ushqimor	32,086.00	Kontraktuar
4	Furnizimi dhe monitimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore- Ri-tender	36,000.00	Në vlerësim
5	Shërbime te udhëtimit me aeroplan	670.00	Kontraktuar
6	Furnizim me artikuj ushqimor mbështetës	9,308.34	Në vlerësim
7	Furnizim me pemë dhe perime (mini-tender)	16,444.15	Kontraktuar
8	Furnizim me pemë dhe perime (mini-tender)	81,855.80	Kontraktuar

Gjatë këtij tre (3) muji zyra prokurimit ka zhvilluara procedurat e mësipërme, mini-tenderët (pemë dhe perime) AQP-ja, ka rekomanduar që të shpallën si procedura sezonale në mënyrë që kursejmë paranë andaj, janë dy procedura për furnizim me pemë dhe perime. Po ashtu, kemi zhvilluar komunikim me AQP-në, për të vazhduar me procedurat për artikuj ushqimor dhe naftë siç kemi qenë deri tani e që janë në përfundim e sipër. Janë gjithsej 7 lot-e që nënkupton 7 kontrata që i ka zhvilluar AQP-ja, si furnizim me brumëra, mish, bylmet dhe artikuj të tjerë ushqimor, në të cilat ne planifikojmë të bëhemi pjesë e tyre. Artikujt që ne i shfrytëzojmë për aktivitet tona në Kuzhinë e që nuk janë të përfshirë në lot-et e AQP-së, i kemi shpallur vetë si procedura tre (3) dhe gjashtë (6) në tabelën më sipër.

Procedura për sigurimin shëndetësor dhe aksidental për punëtorët e Kuzhinës Qendrore ka filluar implementimin prej 29.09.2023 dhe është për periudhën tre (3) vjeçare.

Furnizimi dhe monitimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore- Ri-tender, është në fazën e vlerësimit pasi është ri-tenderuar si rezultat i anulimit nga tenderimi i kaluar. Furnizim me material higjienik është kontraktuar dhe është për periudhën një (1) vjeçare. Si dhe për shërbimet e udhëtimit me aeroplan është kontratë minimale që është zhvilluar për blerjen e një bilete aeroplani.

ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Ndërmarrja gjatë këtij tremujori ka shënuar përparim të konsiderueshëm në rritjen e bashkëpunimit me media dhe paraqitjen në rrjete sociale për të pasqyruar punën e stafit që bëhet për fuqizimin e ndërmarrjes dhe të shërbimit. Praktikë e vazhdueshme e ndërmarrjes është marrja e inputeve nga klientela dhe përmirësimi i shërbimeve në vazhdimësi.

Gjatë këtij tre mujori ndërmarrja ka publikuar revisten tashmë mujore Kuz'ina në tre vëllime. Në revista përfshihen aktivitete e muajit në ndërmarrje, informacione të ndyshme rreth shëndetit, këshilla, si dhe intervistat me staf.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës i ka kryer me përgjegjësi detyra e ndryshme për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të organizatës.

Disa prej punëve të departamentit të administratës janë:

Menaxhimi i dokumentacionit: Departamenti Administratës është kujdesur për ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit të kompanisë. Kjo ka përfshirë shpërndarjen, arkivimin dhe mbajtjen në kontroll të dokumenteve të rëndësishme, si kontratat, faturat, raportet financiare, regjistrat e punëtorëve, dhe të tjera.

Ka bërë mbulimin kërkesave të brendshme dhe të jashtme: Departamenti i Administratës ka rolin e të përgjigjet ndaj kërkesave të brendshme dhe të jashtme të organizatës. Kjo përfshin pranimin dhe drejtimin e telefonatave, e-maileve dhe kërkesave tjera të punonjësve, klientëve, dhe partnerëve të biznesit. Ka bërë menaxhimin e furnizimeve dhe inventarit.

Kjo përfshin vendosjen e porosive për materiale zyre, pajisje kompjuterike, mobilje, etj., dhe mbajtjen në kontroll të inventarit për të siguruar që të gjitha nevojat janë të plotësuara dhe të disponueshme. Në periudhen raportuese Departamenti i Administratës ka asistuar në planifikimin dhe koordinimin e evenimenteve dhe takimeve të organizatës. Kjo përfshin rezervimin e hapësirave, organizimin e udhëtimeve dhe akomodimeve, sigurimin e nevojave teknike, dhe planifikimin e detajeve të tjera që lidhen me takimet.

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektore: Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale (Aktash, Tophane) si dhe sektori privat.

Në sektorin e Institucioneve Parashkollore të cilin e kemi përgatitur “Doracak për shërbimin dhe sigurinë e ushqimit” ky doracak është aplikuar nga stafi ku janë të përfshira:

- Higjiena personale dhe kujdesi,
- Rregullat e veshjes në punë
- Rregullat higjienike dhe të mirësjelljes gjatë servimit të ushqimit
- Fasiliteti sanitare
- Ushqyerja e fëmijëve
- Menaxhimi i papastërtive (mbetjeve)

ky doracak është punuar bazuar në *LIGJIN 037-L016* për ushqimin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Po ashtu në departamentin e prodhimit janë vendosur rregullat për mirëmbajtjen dhe sigurinë ushqimit nëpërmjet kontrollimit të temperaturave të magazinave dhe frigoriferëve, .

Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve merren mostrat nga çdo lloj i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë :

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike si dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar. Gjatë periudhës tre mujore janë marrë strisho të ndryshme në kuzhinë si dhe në produktet të ndryshme dhe analizën e ujit, gjë që rezultatet kanë qenë të kënaqshme nuk janë gjetur asnjë nga këta parametra si: Salmonella, Staphylococcus aureus, Escherichia coli, Bakteret koliforme, Numri i përgjithshëm i baktereve të gjalla mezofile që do të thotë se “Departamenti i prodhimit” ka pasur arritje të lartë në cilësinë e higjienës.

Sektori Qendrat sociale

Sektori i qendrave sociale pasi që ka një meny të begatshme, janë shpërndarë shujta të nxehta dhe me vlera ushqyese, është pasuruar me pemë, djathë, sallat.

Sektori privat

Sektori privatë gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyer në cilësinë si dhe është pasuruar menya me produkte të reja lloje të ndryshme të gjellave si: sallata verore, kemi shtuar edhe llojet të ndryshme të ëmbëlsirave si: bombica ,ravani me sherbet, rrollada ,gurabija,pite me molla. Ndër produktet më të kërkuara kanë qenë: gullashi, pasuli, patate në furrë, file pule, hamburgeri, specat të mbushur.

Sektori privat ka zhvilluar po ashtu “finger food”ku kemi pasur organizime të ndryshme kokteje rasti .

Sektori privat gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur numri i porosive 11,541

Përgatitja e shujtave Korrik – Shtator

Numri i shujtave

Sektori	Korrik	Gusht	Shtator	Totali 3 Mujor
Institucionet Parashkollore	28148	31047	44887	104,082
Qendrat Sociale	6300	6000	6300	18600
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	300	3150	3150	9300
Privat	2976	4342	4223	11,541
Total				143,523

DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT

Në tremujorin e tretë, Departamenti i Furnizimit dhe distribuimit është funksionalizuar thuajse tërësisht, duke angazhuar staf shtesë për të kryer detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë. Megjithatë gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës “Në shtëpi”, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës. Te dhënat lidhur me distribuimin dhe vlerën e furnizimeve janë të paraqitura në tabele tek Departamenti i Financave.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave kujdeset për sigurimin e likuiditetit të ndërmarrjes, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe investimet e planifikuara. Ndërmarrja ka siguruar të hyra nga aktiviteti primar i saj dhe shpenzime të cilat i përcjellin këto të hyra. Shpenzimet kryesisht janë kosto direkte në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit, gjithashtu këtë periudhë ka pasur shpenzime të periudhës jo prodhuese indirekte.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit afarist ndërmarrja ka krijuar shpenzime të përgjithshme variable të tilla si shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet për derivate.

Bazuar në planin paraprak të prokurimit, ndërmarrja këtë periudhë të vitit ka iniciuar procedura për furnizim me disa produktet të lendes se parë dhe gjithashtu ka bërë investim ne bufe- restaurantin e kuzhinës dhe receptionin vlera e se cilit është paraqitur ne tabel.

Zëri i cili merr pjesë me së shumti në shpenzimet e ndërmarrjes është Furnizimi me lëndë të parë. Në këtë periudhë ndërmarrja ka shpenzuar për blerjen e lëndës së parë në vlerë:

Kurse periudhën e dytë të vitit ndërmarrja ka shpenzuar 110,272.99 euro për blerjen e lëndës së parë. Krahasuar me periudhën e parë të vitit, ndërmarrja ka rritur për 26,175.03 euro furnizimet me lende të parë.

	Korrik	Gusht	Shtator	Totali
Totali i shpenzimeve	43,388.64	52,235.63	44,759.86	140,384.13
Lënda e parë	30,559.26	30,260.72	40,023.25	100,843.23
Shpenzime për naftë	753.98	711.17	658.39	2,123.54
Shpenzime për konkurs		161	80.5	241.50
Shpenzime për telefon	26.43	95.41	28.07	149.91
Shpenzime për trajnime-avancim		2850		2,850.00
Shpenzimet e udhëtimit			584.74	584.74
Shpenzime të reprezentacionit	242.2	68.9	118.98	430.08
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55
Shpenzimet e ujit			2	2.00
Shpenzime për energji elektrike	1588.05	1665.57	1549.64	4,803.26
Shpenzime për materialshpenzues	27.16	76.27		103.43
Shpenzimet për zyre	355.85	105.80	156.79	618.44
Shpenzimet e reklamës	271.83			271.83
Shpenzimet e higjienës			249.41	249.41
Shpenzimet e dezinfektimit				0.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes	295.77			295.77
Shpenzimet e mirëmbajtjes së veturave	55.00	119.89		174.89
Shpenzime për paketime ushqimore	437.71	642.37		1,080.08
Shpenzim Aset	8,404.93	12,647.08		21,052.01
Shpenzime tjera	53.56	2780.6		2,834.16
Shpenzime të dënimeve të policisë			60	60.00
Shpenzime të mirëmbajtjes së ambientit të jashtëm			1119.31	1,119.31
Shpenzime të analizave laboratorike	266.06			266.06

TM3

Zëri tjetër që zë vend në ndarjen buxhetore të shpenzimeve është ai për energji elektrike, i cili për këtë periudhë ka arritur vlerën prej 4,803.26 euro.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka përfunduar procedurën e ndërtimit të bufes për punëtorë dhe renovimin e hapësirës- recepsionin. Në muajin korrik ka përfunduar blerja e fohesit modular.

Ndarja buxhetore për paga për tre mujorin e tretë të vitit 2023 (euro)

Viti 2023	Paga Bruto
Muaji Korrik	40,926.48
Muaji Gusht	41,384.00
Muaji Shtator	40,071.30
Totali për tre muaj	122,381.78

Në tre mujorin e tretë të vitit 2023, Ndërmarrja ka ndarë buxhet në vlerë prej 122,381.78 euro të destinuar për paga.

Të hyrat dhe llojet e tyre (euro)

Shite	IP dhe QS	Operatore Privat	Total
Muaji Korrik	58,386.44	7,944.49	66,330.93
Muaji Gusht	75,503.57	11,147.79	86,654.85
Muaji Shtator	85,910.41	8,670.42	94,580.83
Totali për tre muaj	207,088.55	27,762.70	234,851.2


Nga tabela lartë mund të shohim të hyrat që ka realizuar ndërmarrja gjatë këtij tre mujori të tretë

Kolona e parë tregon shumën totale mujore në Institucione Parashkollore dhe Qendra Sociale. Krahasuar me periudhën e parë të vitit në këtë sektor (IP dhe QS) ndërmarrja ka shënuar trend negativ në inkasimin e të hyrave, kjo si rezultat i pushimeve vjetore në fund të muajit korrik dhe fillimin e muajit gusht. Nga periudha e kaluar kemi rënie për 41,920.45 euro në këtë periudhë.

Këtë periudhë kohore ka pasur rritje të të hyrave nga shitja tek operatorët privat. Tre mujorishi i tretë i vitit 2023 është mbyllur në vlerën 27,762.70 euro. Kurse në periudhat paraprake kanë qenë 16,377.13 euro, kurse në periudhën e parë ka qenë 13,313.85 euro. Totali i të hyrave pa TVSH, për ndërmarrjen është 234,851.25 euro.

Në këtë tabelë nuk janë përfshirë të hyrat nga subvencioni i Ministrisë së Financave (masa.3.4) ku vlera e saj në këtë periudhë është 21,186.44 euro.


Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve mujore



Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSh	Korrik	Gusht	Shtator
	5,365.66	7,898.37	11,945.11

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve krahasim TM1- TM2-TM3




Përmbledhje: Ndërmarrja ka shënuar rritje në përfshirjen e tregut privat ku kjo periudhë është rritur për 11,383 euro, më shumë se periudha e kaluar. Ky progres ka ndodhur si rezultat i rritjes së shërbimit të cateringut, shpërndarjes tek klientë të biznesit dhe atyre privat.

Tre mujorshin e tretë të vitit ndërmarrja e ka mbyllur me bilanc negativ si rrjedhojë i investimeve të realizuar sipas Planit të Biznesit, ku në këtë periudhë janë realizuar investimet e përshkuara me lartë.

Buxheti i pagave ka pasur një trend stabil të shpërndarjes së buxhetit.

Shpenzimet janë rritur në tre muaj, si rezultat i rritjes së kërkesës për lëndë të parë rritjes së çmimeve dhe realizimit të investimeve.

TM4



ZYRA E PROKURIMIT

Aktivitetet e prokurimit këtë periudhë kanë vazhduar sipas planifikimit të prokurimit dhe sipas nevojave të domosdoshme për mirë-funksionim të ndërmarrjes për më tepër tabela në vijim:

Nr.	Aktiviteti i Prokurimit	Shuma (€)	Procesi
1	Hostimi dhe Mirëmbajtja e ueb-faqes së Kuzhinës Qendrore 12 muaj	944	Kontraktuar
2	Furnizim dhe montim për paisjen për vijueshmëri në punë	980	Anuluar
3	Furnizim me paketime ushqimore	9,730.62	Kontraktuar
4	Sigurimi i veturave të Kuzhinës Qendrore	705.29	Kontraktuar
5	Furnizim me dhurata për fundvit	970.00	Kontraktuar

Gjatë këtij tre (3) mujori zyra e prokurimit ka zhvilluara procedurat e mësipërme. Hostimi dhe mirëmbajtja e ueb-faqes së Kuzhinës Qendrore është kontratë për 12 muaj, ku do të mirëmbahet ueb-faqja. Procedura lidhur me vijueshmërinë në punë është anuluar pasi nuk kemi pranuar asnjë ofertë.

Procedura për furnizim me paketim ushqimore është aktivitet një-vjeçar, ku përfshihen paketim sipas nevojave të Kuzhinës për konsumatorët e saj. Ndërsa, sigurimi i veturave përfshin sigurimin e të gjitha veturat e Kuzhinës. Si dhe procedura e fundit për vitin 2023, është ajo për furnizim me dhurata për fundvit, ku janë blerë dhurata për partnerët tanë si falenderim për bashkëpunimin e mirë gjatë vitit.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është përgatitur edhe plani i prokurimit për vitin 2024, ku gjatë muajit Janar, ky plan duhet të dërgohet në Agjencinë Qendrore të Prokurimit. Si dhe është dorëzuar në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik raporti i kontratave të nënshkruara nga Kuzhina Qendrore, në këtë raport paraqitën të gjitha kontratat e nënshkruara nga Kuzhina sic e parashehë legjislacioni për prokurim publik, pra kontrata në vlera minimale, në vlerë te vogël dhe të mesme, si autoritet asnjë kontratë nuk kemi pasur në vlerë te madhe (mbi 125,000euro për furnizim apo mbi 500,000 euro për kontratat për punë). Gjithsej, Kuzhina Qendrore ka nënshkruar 25 kontratat, por këtu nuk përfshihen kontratat që jemi pjesë e AQP-së, si furnizimet me artikuj ushqimore dy lote, furnizimet me mish dy lote, furnizime me bukë dhe brumëra, furnizimi me naftë, dhe furnizimet me produktet e qumshtit.

ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Ndërmarrja gjatë këtij tremujori ka shënuar përparim të konsiderueshëm në rritjen e bashkëpunimit me media dhe paraqitjen në rrjete sociale për të pasqyruar punën e stafit që bëhet për fuqizimin e ndërmarrjes dhe të shërbimit. Praktikë e vazhdueshme e ndërmarrjes është marrja e inputeve nga klientela dhe përmirësimi i shërbimeve në vazhdimësi.

Gjatë këtij tre mujori ndërmarrja ka publikuar revisten tashmë mujore Kuz'ina në tre vëllime. Në revista përfshihen aktivitete e muajit në ndërmarrje, informacione të ndryshme rreth shëndetit, këshilla, si dhe intervistat me staf.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Aktualisht në ndërmarrjen tonë në këtë departament në funksion të plotë janë katër sektor: Sektori i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Projekteve dhe sektori i Logjistikës, ai i Burimeve Njerëzore dhe i IT-së, Funksionet tjera të sektorëve të tjerë do të funksionalizohen në bazë të planifikimeve të brendshme të institucionit tonë, kurse vlen të theksohet se obligimet dhe detyrat që kanë qenë në kompetencë të sektorëve të cilët ende nuk janë të plotësuar me resurse njerëzore i kanë mbuluar stafi aktual i administratës në koordinim të rregullt me Kryeshefin Ekzekutiv dhe me departamentet e tjera.

- Departamenti i Administratës gjatë kësaj periudhe kohore që përkon me tre mujorshin e katërt të raportit të punës, komfort edhe obligimeve me të cilat ky departament ngarkohet në bazë të dispozitave normative, ka kryer këto aktivitete:

Janë përcjellë dhe janë dërguar në kohën e duhur, shujtat ditore tek Kopshtet Publike dhe ato në Bazë në Komunitet, si dhe tek qendrat sociale është dërguar po ashtu në kohën e duhur ushqimi për personat që shërbehen me ushqimin tonë. Në bashkëpunim me Departamentin e Financave, të njëjtat shujta janë regjistruar dhe dokumentet e nevojshme për faturim janë dërguar në Komunën e Prishtinës.

Gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Administratës ka hartuar specifikat për projektin tenderues për sigurimin shëndetësor, dhe pas përfundimit të procedurës në fjalë nga Zyra e Prokurimit, kemi përcjellur se si po zhvillohet procedura zbatuese sa i takon sigurimit shëndetësor.

Në tre mujorin e fundit të vitit Departamenti i Administratës në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit, ka mundur regjistrimin e veturave të ndërmarrjes dhe përfundimin e të gjitha procedurave tenderuese. Në sektorin e IT-së ne si Departamenti i Administratës përmes punonjësit të IT-së, deri më tani kemi arritur t'i ndihmojmë sektorit të marrëdhënies me publikun që të hartoi revistën "Ku'Zina" për muajtë tetor/nëntor/dhjetor. Për të njëjtën revistë, kemi bërë dizajnimin e saj në mënyrë profesionale. Kujtojmë që revista përmbanë kryesisht njoftime mbi ushqimet që përgatiten në Kuzhinë, duke përfshirë nga recetat e ndryshme e deri tek ushqimet për diabetikët.

Punët e kryera në të gjithë sektorët e departamentit, të cilat konsiderojmë që kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e punëve në ndërmarrjen tonë, edhe pse natyrshëm ka shumë vend për përmirësime, ku presim që viti që hyjmë të jetë edhe më me shumë angashime por edhe suksese të cilat natyrisht se do t'i shërbejnë jo vetëm departamentit por edhe ndërmarrjes tonë në përgjithësi.

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, në të gjitha sektorët janë bërë menytë të cilat janë pasuruar me specialitete të ndryshme, po ashtu, të gjithë stafi janë paisur me librezë sanitare.

Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektorë: *Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale (Aktash, Tophane) si dhe sektori privat.*

Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Institucioneve Parashkollore është mbledhur komisioni, është bërë implementimi dhe vlerësimi i menysë së re e cila është katër javore dhe është e pasur me vlera të larta ushqyese, po ashtu ka produkte të reja në meny me të cilat fëmijët me kalimin e kohës janë duke u adaptuar me shije të re.

Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve merren mostrat nga çdo lloj i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë:

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike si dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar.

Ndërmarrja ka arritur marrëveshje me IKSHPK për kontrollen rutine të ambientit dhe ushqimit. Mostrat të cilat merren analizohen dhe komentohen rezultatet me rekomandimet e dhëna nga instituti të cilat me pas implementohen nga Kuzhina Qendrore.

Gjatë kësaj kohe nga ky departament kanë dalur disa ide të reja lidhur me pasurimin e menysë të ofruar në sektorin privat. Kërkesë e këtij departamenti është prodhimi dhe paketimi i produkteve me afatgjatësi si reql me fruta apo turshi. Lidhur me këto ide jemi duke i analizuar mjetet dhe lejet e nevojshme për fillimin e këtij procesi.

Sektori Qendrat sociale

Në departamenti e prodhimit është po ashtu sektori i qendrës sociale ku në këtë sektor përgatitet ushqimi për dy qendra: Qendra në Aktash si dhe Qendra në Tophane, gjatë periudhës përgatitet ushqimi për dy qendra: Qendra në Aktash si dhe Qendra në Tophane, gjatë periudhës tre mujore është bërë implementimi i menysë e cila është dy javore është e pasur me vlera të larta ushqyese, çdo ditë shkojnë gjella të ndryshme të shoqëruar gjithmonë me sallatë ose djathë.

Sektori privat

Sektori privatë gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyer në cilësinë si dhe është pasuruar menya me produkte të reja lloje të ndryshme të gjellrave, lloje të ndryshme të brumërave.

Sektori privat ka zhvilluar po ashtu “finger food” ku kemi pasur organizime të ndryshme kokteje rasti. Gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur të zgjerojë bashkëpunimin për evente më të mëdha edhe me individ privat.

Përgatitja e shujtave Tetor – Dhjetor

Numri i fëmijëve	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
Institucionet Parashkollore Publike	31399	29339	27048
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	19135	18480	17600
Qendrat Sociale	6600	6300	6000
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	3300	3150	3000
Porosi Private	68-Individual (1330 Porosi) 6-Biznese (1833 Porosi) 1-Catering	50-Individual (1016 Porosi) 6-Biznese (2086 Porosi) 1-Catering	51-Individual (1046 Porosi) 5-Biznese (3028 Porosi) 1-Catering

DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT

Në tremujorin e dytë departamenti i furnizimit dhe distribuimit është funksionalizuar thuajse tërësisht, duke angazhuar staf shtesë për të kryer detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë. Megjithatë gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës” Në shtëpi”, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës. Te dhënat lidhur me distribuimin dhe vlerën e furnizimeve janë të paraqitura në tabelë tek departamenti I fianncave.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave kujdeset për sigurimin e likuiditetit të ndërmarrjes, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe investimet e planifikuara. Ndërmarrja ka siguruar të hyra nga aktiviteti primar i saj dhe shpenzime të cilat i përcjellin këto të hyra. Shpenzimet kryesisht janë kosto direkte në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit, gjithashtu këtë periudhë ka pasur shpenzime të periudhës jo prodhuese indirekte.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit afarist ndërmarrja ka krijuar shpenzime të përgjithshme variable të tilla si shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet për derivate.

Bazuar në planin paraprak të prokurimit, ndërmarrja këtë periudhë të vitit ka iniciuar procedura për furnizim me paketime parë dhe gjithashtu ka bërë instalimin e sistemit solar ku nje situacioni i parë është përfunduar ne muajin dhjetor, i financuar nga subvencioni i Komunes se Prishtines.

Zëri i cili merr pjesë me së shumti në shpenzimet e ndërmarrjes është Furnizimi me lëndë të parë. Në këtë periudhë ndërmarrja ka shpenzuar për blerjen e lëndës së parë në vlerë: 95,122.32 euro.

Krahasuar me periudhën paraprake shpenzimet për lëndë të parë ishin 100,843.23 euro.

Zëri tjetër që zë vend në ndarjen buxhetore të shpenzimeve është ai për energji elektrike i cili për këtë periudhë ka arritur vlerën prej 4,221.60 euro.

Ndarja buxhetore për paga për tre mujorin e trete të vitit 2023 (euro)

Viti 2023	Paga Bruto
Muaji Tetor	42,333.80
Muaji Nentor	47,391.30
Muaji Dhjetor	81,355.60
Totali për tre muaj	171,080.69

Në tre mujorin e katërt të vitit 2023, Ndërmarrja ka ndarë buxhet në vlerë prej 171,080.69-euro të destinuar për paga.

TM4

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Totali i shpenzimeve	39,259.46	51,102.70	55,259.87	145,622.03
Lënda e parë	33,141.77	34,277.04	27,703.51	95,122.32
Shpenzime për naftë	651.13	829.35	266.02	1,746.50
Shpenzime për telefon	135.59	129.22	110.73	375.54
Shpenzime për trajnime-avancim		7,480		7,480.00
Shpenzimet e udhëtimit		3,958.64		3,856.96
Shpenzime të reprezentacionit	58.47	171.81	296.95	527.23
Shpenzime të interneti		101.7	50.85	152.55
Shpenzimet e ujit	2.00			2.00
Shpenzime të rrymës	1,579.90	1,340.42	1,301.28	4,221.60
Shpenzime për material shpenzues	35.84	17.46	58.6	111.90
Shpenzimet për zyre	85.79	217.17	282.12	585.08
Shpenzimet e reklamës (dhuratat)			956.78	956.78
Shpenzimet e reklamës	197.68	16.10	32.2	245.98
Shpenzimet e higjienës	431.95	290.26	247.88	970.09
Shpenzimet e mirëmbajtjes së veturave	87.00	185.39	178.7	451.09
Shpenzimet e mirëmbajtjes së paisjeve të kuzhinës			254.24	254.24
Shpenzimet e paketimeve	468.64	304.24	340.19	1,113.07
Shpenzime tjera (ushqimit)			203.14	203.14
GPS i veturave	67.80			67.80
Shpenzimet për analiza IKSHPK	532.00			532.00
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	1,783.90	1,783.9	1,808.7	5,376.50
Aset (Subvencion)			21,167.98	21,167.98

Të hyrat dhe llojet e tyre (euro)

Shitje	IP dhe QS	Operatore Privat	Totali
Muaji Tetor	101,074.86	7,316.94	108,391.80
Muaji Nëntor	104,439.30	6,229.80	110,669.10
Muaji Dhjetor	85,844.30	7,981.05	93,825.35
Totali për tre muaj	291,358.96	21,527.79	312,886.75


Nga tabela lartë mund të shohim të hyrat që ka realizuar ndërmarrja gjatë këtij tre mujori të tretë.

Kolona e parë tregon shumën totale mujore në Institucione Parashkollore dhe Qendra Sociale. Krahasuar me periudhën e parë të vitit në këtë sektor(IP dhe QS) ndërmarrja ka shënuar trend pozitiv në inkasimin e të hyrave. Nga periodha e kaluar kemi rritje për 84,270.41 euro në këtë periudhë.

Këtë periudhë kohore ka pasur rënie të të hyrave nga shitja tek operatorët privat. Tre mujorishi i katërt i vitit 2023 është mbyllur në vlerën 21,527.79 euro. Në këtë periudhë krahasuar me TM3, të hyrat nga sektori privat kanë rënë për 6,234.91 euro. Arsye për këtë mund të jetë ndryshimi i klimës, duke qenë se klientët me numër më të madhë vijnë nga fusha e ndërtimtarisë si dhe pushimet dimrore.

Totali i të hyrave pa TVSH, për ndërmarrjen në këtë periudhë të vitit është 312,886.75 euro.


Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve mujore



Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
	14,478.95	13,237.26	8,465.94	36,182.15

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve krahasim TM1- TM2-TM3- TM4



Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes

Periudha raportuese është karakterizuar më një vëllim të punëve në drejtim të rritjes së kapaciteteve sa i përket resorit të burimeve njerëzore. Është përgatitur procesi rekrutues për nevoja për staf shtesë për ndërmarrjen. Gjatë kësaj periudhe kohore ndërmarrja ka organizuar trajnimin e stafit të ndërmarrjes. Tematika e këtij trajnimi ka qenë menaxhimi i kontratave në prokurimin publik, sigurinë në punë etj.

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Si rezultat i kësaj analize është përgatitur dokumenti për nevojat e ndërmarrjes për staf shtesë.

Anex**1 Lista e Institucioneve parashkollore****I. Publike**

- 1.IP Yllkat
- 2.IP Ardhmëria
- 3.IP Xixëllonjat
- 4.IP Dielli
- 5.IP Buzëqeshja
- 6.IP Fatosat
- 7.IP Lulevera
- 8.Gëzimi Ynë

II. Me bazë në komunitet

- 1.IP Botanika
- 2.IP Cicërimat
- 3.IP Këtrushet
- 4.IP Milingonat
- 5.IP Ngjyrat
- 6.IP Shkronjat
- 7.IP Zogjet
- 8.IP Shtëpia magjike



Numeri i telefonit **+383 45 709 106**



Email **kuzhinaqendrore@gmail.com**



Website **www.kuzhina.net**



Address **Rruga Egnatia , Pristina, Kosovo**